



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmentant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr. 61/2021

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Filloreta Lekiqi, kryesuese, Musë Povataj dhe Myjesere Muiku anëtarë të Komisionit Disiplinor, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat [redacted] si organ përmbarues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për territorin e Gjykatës Themelore në [redacted] pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesja e autorizuar e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Burbuqe Spahija – Kërveshi, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, si dhe përmbaruesi privat z. [redacted] e në mungesë të palës ankuese [redacted] por e ftuar me rregull, dhe pas seancës këshillimore dhe votimit me datën 01.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHEN SI TË PABAZUARA** Raporti Përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë, Departamenti për Profesione të Lira – Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-61/2021, i datës 17.12.2021, si dhe ankesa e palës ankuese [redacted] nga fshati [redacted], komuna e [redacted], e datës 03.12.2021;
- II. Organi përmbarimor – përmbaruesi privat [redacted] **NUK ËSHTË PËRGJEGJËS** për shkelje të pretenduara disiplinore në lëndën P.nr.1442/19.

A r s y e t i m

Me datë 03.12.2021, pala ankuese [redacted] nga fshati [redacted], komuna e [redacted] ka deponuar kërkesë në Departamentin për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat të Ministrisë së Drejtësisë, dokument ky që kishte efekt të ankesës, e e paraqitur ndaj përmbaruesit privat [redacted] i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në [redacted]. Ankesa kishte të bënte lidhur me lëndën P.nr.1442/19, sipas evidencave të përmbaruesit privat [redacted], lëndë kjo ku pala ankuese kishte cilësinë e debitorit, ndërsa kreditor ishte [redacted], me seli në Prishtinë. Me datë 06.12.2021, në përputhje me nenin 3 të Udhëzimit Administrativ MD-nr.09/2014 për Procedurën Disiplinore

ndaj Përmbauesit Privat, DPL të njëjtën e kishte kthyer tek pala ankuese për plotësim, porse anjherë nuk ishte pranuar një plotësim i ankeses bërë nga pala ankuese.

Sidoqoftë, me datë 06.12.2021, Departamenti për Profesione të Lira, Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat i Ministrisë së Drejtësisë, mbi bazën e propozimit të paraqitur nga pala ankuese dhe infomatave në dispozicion, ka paraqitur Raportin me propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbauesit privat me propozimin për ndërmarrjen e veprimeve ligjore. Sipas Raportit në fjalë, përmbauesi privat kishte kryer shkelje disiplinore duke mos zhbllokuar llogaritë bankare të palës ankuese, pas përjashtimit të tij nga procedimi i lëndëve të kreditorit Tutje, sipas Raportit, me bllokimin e llogarive bankare, pala ankuese ishte dëmtuar financiarisht duke mos u lejuar as edhe tërheqja e rrogës dhe shtesave të fëmijëve.

Me datë 31.12.2021 përmbauesi privat z. është përgjigjur me shkrim ku ka deklaruar, ndër të tjera, se ankesa ndaj tij është e paqëndrueshme dhe e pabazuar juridikisht. Ka theksuar se në rastin në fjalë, Gjykata Themelore në Pejë, Dega në Decan, me Aktvendimin EP.nr.107/2019, të datës 21.07.2020, kishte refuzuar prapësimin e debitorit, këtu pala ankuese, dhe pas kalimit të afatit për ankesë, me datë 25.01.2021, përmbauesi privat kishte pranuar prapa shkresat e lëndës në fjalë. Kurse me datë 02.03.2021, ai kishte lëshuar Urdhër për bllokim të llogarive bankare të debitorit. Ndërsa, me Aktvendimin GJA.nr.423/21, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, i datës 21.07.2021, përmbauesi privat ishte përjashtuar nga procedimi i mëtejme i rasteve të kreditorit. Prandaj, ka theksuar, me pranimin e këtij vendimi, nuk ka asnjë kompetencë dhe të drejtë të ndërmarrë veprime sa i përket këtyre lëndëve, rrjedhimisht edhe cfarëdo veprimi që mund të ndërmerret, i tejkalon kompetencat e tij edhe pse llogaritë bankare të disa prej debitorëve kanë mbetur të bllokuara dhe do të mbesin të tilla deri në ndërmarrjen e hapave të mëtejme në lidhje me lëndët. Po ashtu ka theksuar se më pastaj pala ankuese i kishte paraqitur dëshmi se me datën 12.11.2021 kishte paguar borxhin drejtpërdrejt në llogarinë e kreditorit porse, duke qenë se përmbauesi privat tashmë ishte përjashtuar nga procedimi i lëndës në fjalë me vendim të gjykatës, i njëjti nuk ka mundur të ndërmarrë asnjë veprim në lidhje me çështjen. Tutje ka theksuar se debitorit, gjegjësisht palës ankuese, ia ka dhënë udhëzimet e nevojshme në vizitën e saj në zyrën e përmbauesit, duke i shpjeguar se lëndët, me procesverbal, janë dorëzuar tek kreditor. Ndaj Komisionit i ka propozuar që të refuzoj të pabazuar këtë ankesë dhe përmbauesin privat ta shpallë jopërgjegjës. Komisionit e ka njoftuar se pala ankuese i, në Ministrinë e Drejtësisë kishte paraqitur edhe një ankesë tjetër ndaj këtij përmbauesi privat (rasti që identifikohet si DPL.nr.39/19), e në të cilën përmbauesi privat ishte shpallur jopërgjegjës.

Me datë 24.12.2021, Komisioni Disiplinor ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore, në të cilën kanë prezantuar e autorizuara e Ministrisë së Drejtësisë – Departamenti për Profesione të Lira, Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Burbuqe Spahija Kërveshi, përmbauesi privat z. i emëruar në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, ndërsa ka munguar pala ankuese edhe pse e njëjta ishte ftuar në mënyrë të rregullt për seancë dëgjimore. Ndaj, Komisioni Disiplinor ka mbajtur seancën dëgjimore pa prezencën e palës ankuese, të ftuar në mënyrë të rregullt, por që nuk kishte paralajmëruar e as arsyetuar mungesën në këtë seancë.

E autorizuara e Ministrisë së Drejtësisë, – Departamenti për Profesione të Lira, Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Burbuqe Spahija Kërveshi, ka qënduar pranë raportit me

shkrim dorëzuar Komisionit, dhe tutje ka shtjelluar propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat, duke propozuar shqiptimin e masës disiplinore adekuate në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përmbaruesi privat [] në deklarin e dhënë në seancë dëgjimore, ka qëndruar pranë përgjigjes me shkrim të dorëzuar në Minisitrinë e Drejtësisë në lidhje me çështjen, duke thirrur se borxhi i debitorit, gjegjësisht palës ankuese [] ndaj kreditorit [] është mbyllur me datë 12.11.2021, ndërsa përmbaruesi privat [] është përjashtuar nga procedimi i lëndëve të këtij kreditori, rrjedhimisht edhe të palës ankuese, me vendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 21.07.2021 (Aktvendimi GJA.nr.423/21, v.j.).

Komisioni me kujdes, vëmendje të vecantë dhe në mënyrë shteruese, ka cmuar vec e vec çdo provë të administruar në seancën dëgjimore, si dhe të gjitha së bashku, dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, ka ardhur në përfundim se gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të këtij vendimi është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të saktë, dhe se përmbaruesi nuk ka kryer vepër disiplinore. Për të vërtuar gjendjen faktike, Komisioni ka administruar provat e bashkangjitura Raportit zyrtar për fillim të procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat [], si dhe provat e paraqitura nga përmbaruesi privat [].

Komisioni e sheh të arsyeshme që të shtjellojë problematikën e çështjes që nga fillesat e saj. Kështu, me datë 22.05.2019, [] në cilësi të kreditorit, tek përmbaruesi privat [] kishte paraqitur Propozim për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm, për vlerën e borxhit prej 1,800.00 euro, e kundër debitorit []. Ndaj Urdhrit për lejimin e përmbarimit, debitori me datë 03.06.2019 kishte ushtruar prapësim, ndërsa me Aktvendimin EP.nr.107/19, të datës 21.07.2020, Gjykata Themelore në Pejë, Dega në Decan kishte refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke lënë në fuqi Urdhrin e përmbaruesit privat për lejimin e përmbarimit. Pastaj, më datë 02.03.2021, përmbaruesi privat [] kishte lëshuar një Urdhër për dërgimin e të dhënave bankare dhe bllokimin e e atyre llogarive, kundër debitorit []. Që nga kjo datë, pra, llogaritë bankare që i posedonte debitori [] janë bllokuar, e, bazuar në faktet e çështjes, të bllokuara qëndrojnë edhe sot.

Më datë 21.07.2021, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin GJA.nr.423/2021, kishte aprovuar kërkesën e përmbaruesit privat [], ashtu që i njëjti ishte përjashtuar nga procedimi i mëtejshëm i lëndëve ku kreditori ishte [], ndër to edhe lëndën e palës ankuese []. Pas përjashtimit të tij, përmbaruesi privat [] lëndët i kishte kthyer tek kreditori [].

Meqë në ditën e kthimit të lëndës tek kreditori, llogaria e palës ankuese [] kishte qenë e bllokuar me Urdhër të përmbaruesit privat [] ajo ka vazhduar të mbetet e tillë edhe pas kthimit të lëndës, e edhe tani teksa po zhvillohet një procedurë disiplinore ndaj përmbaruesit privat [] pikërisht për shkakun e pamundësisë së zhblokimit të llogarisë bankare të palës ankuese. Ndërkohë që, kërkesa e kreditorit [] ndaj debitorit ishte përmbushur në tërësi më 12.11.2021.

Me nenin 325 [Përjashtimi] të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), është paraparë se [d]ispozitat e ligjit të procedurës kontestimore për përjashtimin e gjyqtarëve vlejné përshatshëmërisht edhe për përjashtimin e përmbaruesve privat. Ndërsa me nenin 67 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK) janë paraparë shkaqet e përjashtimit të

gjyqtarit, rrjedhimisht edhe të përmbauesit privat, ndërsa me nenin 71, par. 1 të LPK-së, është paraparë se [g]jykatësi (rrjedhimisht edhe përmbauesi privat, v.j.) *posa ta kuptojë së është shtruar kërkesa për përjashtimin e tij ose ekzistojnë shkaqet për përjashtimin e tij sipas nenit 67 të këtij ligji, është i detyruar ta ndërpresë procedimin dhe ta njoftojë kryetarin e gjykatës.*

Pa dashur që të lëshohet në vlerësimin e bazueshmërisë së kërkesës dhe/ose vendimit gjyqësor, Komisioni kuptoi se me Aktvendimin GJA.nr.423/21, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, i nxjerrë me datë 21.07.2021, është aprovuar kërkesa e përmbauesit privat [] me të cilën i njëjti ka kërkuar që të përjashtohet nga procedimi i mëtejshëm i rasteve ku kreditor ishte [] rreth shkakun se kreditori kishte ushtruar kallëzim penal ndaj përmbauesit privat me pretendimin se i njëjti kishte tejkaluar autorizimet ligjore gjatë procedimit të lëndëve të kreditorit. Pra, që nga momenti i përjashtimit të përmbauesit privat [], me vendim gjyqësor, i njëjti nuk kishte ndërmarrë veprime përmbaimore në rastet që kishte qenë duke i proceduar, e ndër to edhe lëndën e palës ankuese []. Rrjedhimisht, nuk ishin ndërmarrë as veprime me qëllim të zhbllokimit të llogarisë bankare të palës ankuese, llogari kjo që qëndronte e bllokuar në bazë të një Urdhri të përmbauesit privat [] i marrë me qëllim të realizimit të kërkesës së kreditorit [] ndaj debitorit [].

Duke qenë kështu, ky Komision vlerëson se përmbauesi privat [] nuk kishte bërë shkelje disiplinore me që i njëjti nuk ka ndërmarrë veprime me qëllim të zhbllokimit të llogarive bankare të debitorit, duke qenë se kishte arsye për përjashtimin e të njëjtit, gjegjësisht duke qenë se ishte nxjerrë një vendim gjyqësor që e përjashtonte këtë përmbaues privat nga procedimi i mëtejshëm i lëndëve të kreditorit []. Ndërsa, në kohën kur kërkesa e kreditorit [] ndaj debitorit [] ishte përmbushur në tërësi (e që ishte data 12.11.2021), tashmë kishte kohë që përmbauesi privat [] ishte përjashtuar nga procedimi i lëndëve të këtij kreditori dhe të njëjtat i ishin kthyer kreditorit pas përjashtimit – përmbauesi privat ishte përjashtuar nga procedimi i lëndëve më datë 21.07.2021.

Anasjelltas, do të mund potencialisht të konsiderohej shkelje disiplinore çfarëdo veprimi i ndërmarrë nga përmbauesi privat po që se ai/ajo do të ndërmerre veprime në procedurë pavarësisht arsyeve për përjashtim, dhe kjo është e përcaktuar me nenin 367, par. 1, pika 1.5 e LPP-së. Së këndejmi, Komisioni vlerëson se nuk mund të mbahet përgjegjësi për shkelje disiplinore përmbauesi privat për faktin se ka respektuar dispozitat ligjore sa më sipër. Komisioni jep një vlerësim të tillë pa dashur që të konsiderohet si vlerësim i bazueshmërisë dhe/apo ligjshmërisë së kërkesës së përmbauesit privat për përjashtim, si dhe vendimit të gjykatës lidhur me kërkesën e tillë.

Madje, pas nxjerrjes së vendimit gjyqësor të lartpërmendur, me të cilin përmbauesi privat [] është përjashtuar nga procedimi i lëndës së palës ankuese, ndërmarrja e një veprimi juridik nga ana e tij (pra, e përmbauesit privat), do të kishte potencialisht konsekuencë ligjore abrogimin e tij të mëvonshëm, në kuptim të nenit 325, par. 4 të LPP-së.

Për më tepër, ky Komision vlerëson se mbetet obligim i kreditorit të rastit që të investohet ashtu që të procedojë tutje me procedurën përmbaimore tek të tjerë përmbaues privat, ashtu që rastet, ndaj edhe rasti i palës ankuse, të mos mbetet peng dhe pa marrë një epilog, duke shkaktuar kështu situata me dëme potenciale për palët në procedurë. Kjo ngase, në fund fare, një llogari bankare paraqet aset personal të pronarit të saj, ndaj dhe pamundësia e përdorimit të saj, paraqet pengesë për pronarin, aq më tepër kur ekziston pamundësi ligjore për të hapur

llogari tjetër bankare. Shto kësaj faktin që aktualisht madje nuk ka as kërkesë të hapur të kreditori ndaj debitorit, gjegjësisht palës ankuese

Ky Komision, po ashtu, e sheh të udhës që të inkurajojë edhe angazhimin më të madh të Odës së Përmbauesve Privat të Kosovës me qëllim të zgjidhjes së çështjeve që potencialisht mos të krijojnë situata të pafavorshme për palët në procedurë përmbaimore, në raport me përmbauesit privat.

Komisioni e gjen të rëndësishme për ta cekur që situata në të cilën aktualisht ndodhet pala ankuese, jo vetëm në raport me përmbauesin privat (ndaj të cilit ka kërkuar hapjen e kësaj procedure disiplinore), por duke e konsideruar edhe për të tjera raste të ngjashme, nuk mund të gjejë zgjidhje përmes një procedure disiplinore, porse nevojitet angazhimi dhe veprimi institucional me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje adekuate për rastet aktuale, me veprim edhe për rastet potenciale në të ardhmen. Komisioni Disiplinor nuk ka kompetencë dhënien e një urdhri për zhblokimin e llogarisë bankare, apo edhe kërkesën për ndërmarrjen e një veprimi tjetër përmbaimor, porse shqyrton dhe vendos për shkeljet disiplinore, për cka në rastin konkret gjeti se nuk është kryer një e tillë.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.Nr.61/2021, datë 01.02.2022

Kryesuese e Komisionit Disiplinor,
Fillareta LEKIQI



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ, bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.